


Të Dhëna Faktike

Sekretariati i KKEI



Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime



Lokacioni:

Ministria e Ekonomisë, Sheshi "Zahir Pajaziti",
(ish ndërtesa e Toskanës) 10000
Prishtinë

Kontakti

www.ncei-ks.com
+383 38 200 215 53
info@nced-ks.com

RRETH KKEI

KËSHILLI


KKEI (Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime) është platformë gjithëpërfshirëse për dialogun e nivelit të lartë ndërmjet qeverisë dhe komunitetit të biznesit, ku pjesëmarrës janë edhe përfaqësuesit ndërkombëtar (donatorët aktivë në zhvillim ekonomik). KKEI ka për qëllim të adresojë prioritetet dhe sfidat, të zbatojë të gjitha reformat gjithëpërfshirëse me qëllim të mbrojtjes së ambientit të të bërit biznes. eliminimit të barrierave, forcimit të sektorit privat në Kosovë dhe tërheqjen e investimeve të huaja në vend. Anëtarët janë përfaqësues të ministrive përkatëse si dhe odave apo asociacioneve kyçe të bizneseve në Kosovë. Kjo platformë është e dizajnuar për të krijuar qasje gjithëpërfshirëse në mënyrë që të sigurohet koordinim i plotë ndërmjet palëve. Këshilli ka për synim forcimin e rolit të sektorit privat dhe asociacioneve të biznesit në monitorimin e efikasitetit të reformave të qeverisë.

SEKRETARIATI

Për të rritur efikasitetin e punës së Këshillit dhe për ta bërë një platformë konstruktive për dialogun publiko-privat, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është pajtuar ta mbështesë këtë Këshill për përmirësimin e klimës së të bërit biznes, investimeve dhe qeverisjes së mirë në Kosovë. Mbështetja e BERZH ndaj Këshillit ka të bëjë me krijimin dhe financimin e një Sekretariati të përbërë nga profesionistë të pavarur. Sekretariati profesional i KKEI ka për qëllim të ofrojë mbështetje analitike për punën e Këshillit, mbikqyrë zbatimin e rekomandimeve dhe konkludimeve të Këshillit, dhe të përcjellë kur rekomandimet nuk implementohen në kohë. BERZH do ta vlerësojë nga afër progresin e bërë në vend dhe do të bëjë ndryshime/ përmirësime ku është nevoja, në mënyrë që të sigurohet një funksionim efikas i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.


TAKIMET

Që nga themelimi i Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (ish KKZHE) në fillim të vitit 2019, janë mbajtur 5 takime të Këshillit, dhe 7 grupe punuese, duke bashkëpunuar me 4 qeveri të ndryshme të Republikës së Kosovës. Ndërsa vetëm gjatë vitit të fundit, një sërë aktivitete janë mbajtur rreth situatës së krijuar nga pandemia.



Ndër aktivitetet kryesore të Sekretariatit të KKEI është zhvillimi, përpunimi dhe vlerësimi i rekomandimeve dhe kërkesave të sektorit privat.

Në figurën e vijuese pasqyrohet numri i kërkesave të sektorit privat ndaj institucioneve përkatëse.



TRANSPARENCA



Që nga themelimi i Sekretariatit, transparenca e punëve të Këshillit është rritur për 100%

Tashmë Sekretariati ka faqen e tij zyrtare në internet si dhe rrjetet e tjera sociale të cilat përdoren si mjet informimi dhe komunikimi. Në faqen e tij të internetit mund të gjenden të publikuara të gjitha aktivitetet e Këshillit si dhe të Sekretariatit qysh nga fillimi i punës së Këshillit në vitin 2012. Ndër të tjera në këtë faqe të publikuara gjenden raportet vjetore, buletine mujore dhe tremujore, dhe publikime të tjera lidhur me aktivitetet e Sekretariatit të KKEI.

26

Procesverbale të takimeve të Këshillit

7

Grupe punuese dhe koordinuese - Agjenda dhe procesverbale

3

Buletine mujore dhe tremujore

3

Publikime të analizave dhe raporteve të Sekretariatit

Përveç anëtarëve dhe pjesëmarrësve të Këshillit, Sekretariati i KKEI ka bashkëpunuar ngushtë edhe me partnerë të tjerë siç është Komisioni Parlamentar për Ekonomi.

Gjatë dëgjimeve publike rreth ligjeve dhe iniciativave të ndryshme, Sekretariati i KKEI ka dhënë komentet dhe rekomandimet e tij në lidhje me temat specifike.

ANALIZA DHE DOKUMENTE TË PËRGATITURA NGA SEKRETARIATI

1 GJYKATA KOMERCIALE

Ekipi i Sekretariatit të KKEI ka analizuar projektligjin për themelimin e gjykatës komerciale ku edhe kanë dhënë rekomandimet e tyre profesionale. Ky projektligj është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2 TREGTIA E BRENDSHME

Ky projektligj i cili është në kuadër të MINT, është kthyer në rishikim dhe pritet të aprovohet brenda kësaj legjislature. Edhe në këtë projektligj Sekretariati i KKEI ka kontribuar me komente dhe rekomandime me synim që të krijohet një kornizë ligjore sa më gjithëpërfshirëse dhe praktike.

3 KAMATË-VONESAT

Sekretariatit të KKEI ka bërë interpretimin e kamatë-vonesave ndërmjet bizneseve

4 TREGTIA E JASHTME

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është përgjegjëse për hartimin e këtij ligji. Sekretariati i KKEI ka dhënë komentet dhe rekomandimet e tij, dhe ligji tashmë është miratuar nga Qeveria.

5 INSPEKTIMET

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është përgjegjëse për hartimin e ligjit për inspektimet ku Sekretariati i KKEI ka kontribuar duke dhënë komente dhe rekomandime. Ligji ende nuk është proceduar në Qeveri.

6 NDIKIMI I PANDEMISË NË PUNËSIM DHE TREGUN E PUNËS

Hartimi i ligjit të punës është përgjegjësi e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Sekretariati i KKEI ka dhënë kontributin e tij duke dhënë rekomandime dhe analiza, si dhe duke mbajtur takime lidhur me ndikimin e pandemisë në punësim.

7 PUSHIMI I LEHONISË DHE PUSHIMI PRINDËROR

Ky ligj po ashtu është përgjegjësi e MFPT, dhe Sekretariati i KKEI ka bashkëpunuar në hartimin e këtij ligji përmes rekomandimeve dhe analizave. Projektligji ende nuk është proceduar në Qeveri.

8 ANALIZA E TË BËRIT BIZNES NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës është bërë Analiza e Klimës së të Bërit Biznes në Kosovë.

9 REKOMANDIME MBI HENDEKUN E AFTËSIVE NË TREGUN E PUNËS

Nëpërmjet aktiviteteve të Sekretariatit, si analizat, grupet punuese dhe takime të tjera të ndryshme, janë bërë Rekomandime mbi Hendekun e Aftësive në Tregun e Punës.

10 PËRFSHIRJA E "KUOTËS PREFERENCIALE" PËR NDËRMARRJET VENDORE NË LIGJIN E PROKURIMIT PUBLIK

Në kuadër të Ligjit të Rimëkëmbjes, zyra Kryeministrit ka inicuar plotësim ndryshimin e Ligjit të Prokurimit Publik me qëllim të përfshirjes së "Kuotës preferenciale" për ndërmarrjet vendore. Sekretariati i KKEI ka kontribuar me komente dhe rekomandime vetanake si dhe ato të anëtarëve të saj.

11 INVESTIMET STRATEGJIKE

Hartimi i Ligjit për Investime Strategjike është përgjegjësi e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Sekretariati i KKEI ka komentuar mbi projektligjin e hartuar nga MINT përmes rekomandimeve të natyrës ligjore dhe ekonomike.

12 INVESTIME TË HUAJA

Për Ligjin për Investime të Huaja, Sekretariati i KKEI ka organizuar grupin punues me përfaqësues të sektorit privat, përfaqësues të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, dhe Tregtisë, Avokaturës e Shtetërore, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë,

13 IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK DHE SHËRBIMET E BESUARA NË TRANSAKSIONET ELEKTRONIKE

Ky ligj është miratuar nga Qeveria dhe është proceduar për në Kuvend. Sekretariati i KKEI ka mbështetur hartimin e këtij ligji përmes rekomandimeve dhe analizave.

ANALIZA DHE DOKUMENTE TË PËRGATITURA NGA SEKRETARIATI

14 LIGJI PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

Në hartimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, që është në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, Sekretariati i KKEI ka dhënë rekomandimet e tij përkitazi me mënyrën e transformimit të pronësisë së tyre përmes privatizimit të NP-ve, partneritetit publiko privat, dhe formave të tjera.

15 REKOMANDIME RRETH TRAJTIMIT TË KALLOS


Trajtimi i Kallos bën pjesë në fushëveprimtarinë e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Kjo çështje është ende në proces, dhe Sekretariati i KKEI është duke bashkëpunuar ngushtë me departamentet përgjegjëse në adresimin e kësaj çështjeje.

16 REKOMANDIME MBI BARRIERAT ADMINISTRATIVE

Sekretariati i KKEI ka dhënë rekomandimet e tij Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me barrierat administrative që lidhen me aktivitetet ekonomike.

17 PËRFSHIRJA E KLAUZOLËS SË ARBITRAZHIT NË KONTRATAT PUBLIKE

Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është punuar për përfshirjen e klauzolës për arbitrazhin në kontratat publike.




37.5% e rekomandimeve dhe analizave të Sekretariatit të KKEI janë ende në **proces**.

Ligjet respektive janë në proces të hartimit dhe ende nuk janë aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.




25% e rekomandimeve dhe analizave të Sekretariatit të KKEI janë **miratuar** dhe tashmë kanë hyrë në fuqi



18.8% e rekomandimeve janë ende në **pritse**.

Ligjet respektive janë ende në pritje dhe nuk ka ndonjë zhvillim sa i përket hartimit apo miratimit të tyre.



12.5% e rekomandimeve janë **miratuar nga Qeveria**

Ligjet respektive tashmë janë miratuar nga Qeveria proceduar për në Kuvend.



6.2% janë kthyer në **rishikim** pas komenteve të Sekretariatit të KKEI.

Ligjet si ai i Tregtisë së Brendshme janë kthyer për rishikim të mëtejshëm pas marrjes së rekomandimeve nga ana e Sekretariatit të KKEI.

SEKRETARIATI I



Mbështetur nga



European Bank
for Reconstruction and Development

Korrik, 2021